VENDIM
Nr. 35/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 92/2017, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës; neneve 18, pika 1, dhe 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. Këshilltari ligjor dhe ekonomik i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas rastit, përfitojnë një pagesë shtesë për shkak të vështirësisë në punë. Pagesa vjetore e shtesës për shkak të vështirësisë është jo më shumë se 3 paga mujore dhe jepet sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

V. Punonjësit administrativë të Kolegjit përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune në masën 10% të pagës për pozicion ose të pagës bazë për klasë. Punonjësit administrativë, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyrë të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njërën prej shtesave, atë me vlerën më të madhe.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 12.5.2022.

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJI TË POSAÇËM TË APELIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	Klasifikimi i pagës	Numri
		(2)
I. KRYETAR	**G3***	**1**
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
II. KOLEGJI I GJYQTARËVE		**(6)**
Gjyqtarë	G3*	6
III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR		**(25)**
Këshilltarë juristë	80% e pagës G3*	14
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	11
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	**I-a**	**1**
V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIEN DHE PUBLIKUN		**(14)**
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III-b	5
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	III-b	2
Përkthyes	II-b	4
Koordinator për medien dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritjeje me popullin	III-b	1
VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		**(9)**
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	2
Specialist protokolli/arkivi ****	III-b	1
Magazinier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	1
Shofer/korrier	V	1
TOTAL		**57**

** Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

*** Kategoria e pagës për sekretarin e kryetarit është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

***** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

****** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore*

Lidhja nr. 2

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT